

Dorina është një profesioniste me përvojë dhe me njohuri të thella në sektorin publik ashtu edhe atë privat. Ajo ka shërbyer si ambasadore në shumë evente publike dhe mbledhje qeveritare. Përgjatë përvojës së saj profesionale, ka dëshmuar aftësinë për të nxitur ndryshime të rëndësishme brenda organizatës dhe ka ndikuar në hartimin e politikave publike me qëllimin kryesor të rritjes dhe zhvillimit të sektorit privat, si dhe përmirësimit të klimës së biznesit.

Dorina ka përfunduar studimet në qytetin e Firences në Itali. Ajo ka një diplomë MSC në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane, në Shkenca Politike. Gjithashtu ka një përfunduar një Master në Dixhital Marketing në Turizëm, nga Universiteti European i Romës.

Gjatë karrierës së saj, ajo është pritur nga Women Venture Fund, në New York City për një praktikë profesionale në Biznes & Financë, si një mundësi e ofruar prej AADF-së, Programi i Masterit dhe Praktikës karrierës Profesionale MIP.

Dorina ka punuar si pedagoge e jashtme për të Drejtat e Njeriut, Organizatat Ndërkombëtare dhe Filozofinë e të Drejtave në fakultete të ndryshme private në Tiranë. Pas përfundimit me sukses të Masterit Ekzekutiv në Harvard Business School me temë *“Nxitja e një rritje fitimprurëse”*, Dorina ka praktikuar aftësitë e saj në rolin si Drejtuese Finance në sektorin privat.

Pas 10 vitesh eksperiencë profesionale në sektorin publik, ajo vendos të rikthehet për të kontribuar në procesin e qeverisjes së Shqipërisë, si pjesë e Lead Albania, për tu angazhuar si këshilltare pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.